

MBI AUDITIMIN E USHTRUAR NË DREJTORINË ARSIMORE RAJONALE SHKODËR

Raporti Përfundimtar i Auditimit të ushtruar në **DAR Shkodër**, me objekt: “*Mbi zbatimin e ligjshmërisë dhe rregullshmerisë ek-financiare, për periudhën 1/20/2008 deri me 31/3/2012*” dhe masat për përmirësimin e gjendjes, janë miratuar me Vendimin e Kryetarit të KLSH nr. 124, datë 07/08/2012.

Bazuar në nenet 9 dhe 16 të ligjit nr. 8270, datë 23/12/1997 “Për Kontrollin e Lartë të Shtetit”, ndryshuar me ligjin nr. 8599, datë 1/6/2000, me shkresën nr. 613/7, datë 07/08/2012 dërguar **Zj. Artrida Ferketi, Drejtore e Drejtorisë Arsimore Rajonale, Shkodër**, krahas Raportit Përfundimtar të Auditimit, Kontrolli i Lartë i Shtetit i ka rekomanduar dhe kërkuar zbatimin e masave të mëposhtme:

A. PROPOZIME PËR NDRYSHIME DHE PËRMIRËSIME NË LEGJISLACIONIN NË FUQI

A.1 Për Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës

Gjatë periudhës objekt auditimi, Drejtorisë Arsimore Rajonale, Shkodër, i janë vënë fonde buxhetore në dispozicion për shpenzimet e transportit të mësuesve dhe nxënësve, në vlerën totale prej 134,000,000 lekë. Për pamundësi të realizimit të procedurave të prokurimit, për shkak të mos interesit të operatorëve ekonomik këto shpenzime nuk janë kryer nëpërmjet procedurave të prokurimit, por janë paguar direkt në llogaritë bankare të mësuesve dhe e nxënësve. Pagesat për këtë shërbim janë bërë në zbatim të Udhëzimit të Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës nr. 22, datë 29/5/2008, i cili lejon kryerjen e këtij shërbimi pa procedura prokurimi. Por, ky udhëzim ka dalë dhe bie në kundërshtim me ligjin për Prokurimin Publik, i cili nuk e përjashton procedurën e prokurimit për këtë shërbim. Po kështu, ky udhëzim bie në kundërshtim edhe me VKM nr. 486, datë 8/4/2008 “Për përdorimin e fondeve buxhetore për transportin e mësuesve dhe të nxënësve, që punojnë e mësojnë jashtë vendbanimit”, pasi kjo VKM, përcakton qartazi se, shpenzimet dhe fondi limit për këto shërbime prokurohen në mbështetje të ligjit për Prokurimin Publik. Për pasojë, Autoriteti Kontraktor nuk ka përmbushur objektin dhe qëllimin kryesor të përcaktuar në nenin 1 të ligjit.

Me qëllim eliminimin i kësaj pasaje, **rekomandojmë që:**

- *Ministria e Arsimit dhe Shkencës të shfuqizoi pikën 9, të Udhëzimit të Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës nr. 22, datë 29/5/2008, ndërkohë të kërkojë pranë Këshillit të Ministrave rregullimin ligjor për kryerjen e këtij shërbimi.*

Menjëherë

B. MASA ORGANIZATIVE

B.1 Për Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës

1. Të analizohet gjendja, të nxirren përgjegjësitë dhe të merren masa ndaj punonjësve përgjegjës për:

- *Pagesat e dyfishta për të njëjtin vend pune për 19 punonjës të larguar nga puna në kundërshtim me Kodin e Punës dhe Kontratën Kolektive të Punës, të cilët në zbatim të vendimeve të Gjykatave janë shpërblyer gjatë periudhës objekt kontrolli nga buxheti i Drejtorisë Rajonale Arsimore Shkodër në shumën totale prej 10,336,287 lekë.*

Menjëherë

B.2 Për Drejtorinë Arsimore Rajonale Shkodër dhe Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës

1. Në zbatimin e dispozitave ligjore për marrëdhëniet e punës dhe të pagave u konstatuan, *mangësi dhe parregullsi të shumta*, konkretisht:

- Në mbajtjen dhe përpilimin e listë prezencave si, raste me korrigjime, mos përcaktimin e një formati për listë prezencat për të gjitha shkollat; raste që mësuesit në listë prezencë kanë mbiemër tjetër, ndërsa në listë pagesë kanë tjetër mbiemër,; si dhe raste që në listë prezencë ka të shënuar ditë pune me raport mjekësor dhe në listë pagesë nuk është bërë ndalesa e paaftësisë së përkohshme. Një pjesë të librezave të punës i kanë drejtorët e shkollave dhe pjesën tjetër të tyre e kanë vetë mësuesit, kurse në DAR nuk ka asnjë librezë pune të mësuesve, por janë vetëm dosjet e tyre. Në listë prezencat që plotësojnë drejtorët e shkollave nuk shënohet lënda që jep çdo mësues, kualifikimi si dhe vendbanimi i tyre. Në shumë raste evidentohen ndryshime të numrit të mësuesve, sidomos për mësuesit provizorë dhe në listë prezencë në disa raste ka numër mësuesish provizorë më pak se në listë pagesa. Ka shumë pagesa për orë suplementare si për mësuesit definitivë ashtu edhe për ata provizorë. Nuk kishte kriter të përcaktuara, për zëvendësuesit e mësuesve që ishin me raporte mjekësore për paaftësi të përkohshme, madje përzgjedhja e tyre bëhej vetëm nga specialisti i Burimeve Njerëzore. Në shumë raste dërgohen mësues pa vjetërsi pune dhe pa kualifikim. Shkresat e firmosura nga Drejtore e DAR-it, për emërimin e mësuesve provizor, rezultoi pa numër protokoll dhe pa shënuar vjetërsinë e punës. Përzgjedhja dhe punësimi i drejtuesve të shkollave dhe i mësuesve nga Drejtoria Arsimore bëhej pa konkurs dhe pa zbatuar asnjë kriter të përcaktuar në udhëzimin e Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës nr. 22, datë 29/7/2010 "Për Emërimet e Personelit Mësimor dhe Drejtues në Arsimin Parauniversitar" dhe të Kontratës Kolektive të Punës datë 25/5/2010 ndërmjet MASH, Sindikatës së Pavarur të Arsimit të Shqipërisë dhe Federatës së Sindikatave të Arsimit të Shqipërisë. Pagesat për orë jashtë orarit nga

8,260 mijë lekë që ishin në vitin 2010 janë dyfishuar në 16,942 mijë lekë në vitin 2011, tregon për liberalizim dhe fiktivetet në pagimin e orëve jashtë orarit. Gjithashtu, janë bërë ndalesa të sigurimeve shoqërore e shëndetësore dhe të tatimit mbi të ardhurat personale mbi pagën e ditëve të punonjësve që ishin me raport mjekësor për paaftësi të përkohshme, në kundërshtim me legjislacionin në fuqi.

Me qëllim mënjanimin dhe rregullimin e këtyre parregullsive të mësipërme, **rekomandojmë:**

- *Të përcaktohet dhe të përdoret i njëjti format për listëprezencat në të gjithë shkollat e rrethit të Shkodrës.*

- *Të firmosen të gjithë listëpagesat e punonjësve nga specialistët që i përpilojnë ato për të gjitha shkollat.*

- *Të zbatohet pika 12 e udhëzimit të MASH-it nr. 22, datë 29/7/2010 që, për emërimet e personelit mësimor dhe drejtues në arsimin parauniversitar dhe të aplikohet konkursi sipas modaliteteve të parashikuara në nenin 4, të pikës 4.3 të Kontratës Kolektive të Punës.*

- *Të zëvendësohen mësuesit pa arsimin përkatës, në të gjitha nivelet e arsimit parauniversitar.*

- *Në asnjë rast punonjësit të mos kompensohen financiarisht për kohën e punuar mbi kohën normale të punës, por të kompensohen vetëm me orë ose ditë pushimi.*

- *Të mos bëhen ndalesa të sigurimeve shoqërore e shëndetësore dhe të tatimit mbi të ardhurat mbi pagën e ditëve që punonjësi janë me raport mjekësor për paaftësi të përkohshme.*

Menjëherë

2. Për vitin 2011, nuk është hartuar strategjia e politikave, e cila duhet të përmbajë objektivat strategjike, prioritetet e institucionit dhe planet e veprimit.

Për këtë qëllim, **rekomandojmë që:**

- *Drejtoria Arsimore Rajonale, Shkodër në bashkëpunim me Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës, në përputhje me kërkesat e ligjit për menaxhimin e sistemit buxhetor dhe të menaxhimit financiar e kontrollit, të marrë masa për hartimin dhe miratimin e strategjisë së politikave, e cila të përmbajë qartë objektivat strategjike, prioritetet e institucionit dhe planet e veprimit.*

Menjëherë

3. Njësia (DARSH) për vitin 2011, ka funksionuar në bazë të ligjit për Sistemin Arsimor Parauniversitar, dhe rregullores së brendshme, e cila është miratuar nga DARSH, por duhej të miratohej nga Ministri Arsimit dhe Shkencës, si dhe në rregullore duhej të pasqyroheshin edhe kërkesat e ligjit për menaxhimin financiar dhe kontrollin, në drejtim të përcaktimeve të detyrave të Nëpunësit Autorizues, Nëpunësit Zbatues, të secilit sektor dhe të punonjësve në veçanti.

Për sa me sipër, **rekomandojmë që:**

- *DARSH, në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi, të marrë masa për të reflektuar të gjitha ndryshimet e duhura në rregulloren e brendshme të funksionimit të këtij institucioni.*

Menjëherë

4. Për vitin 2011, nuk janë ndërmarrë hapat e përcaktuara në nenin 21 të ligjit për menaxhimin financiar dhe kontrollin, pasi nuk është hartuar dhe miratuar strategjia e riskut apo përcaktimi i procedurave për menaxhimin e riskut.

Më qëllim eliminimin e mangësive të mësipërme, **rekomandojmë që:**

- *DARSH, në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi të marrë masa për hartimin dhe miratimin e strategjisë dhe regjistrin të riskut, si dhe përcaktimin e procedurave për identifikimin dhe menaxhimin e tij.*

Menjëherë

5. Në zbatim të akteve ligjore në fuqi, për vitet shkollore 2010-2011 dhe 2011-2012, kanë përfituar subvencion nga MASH-i për të kompensuar çmimet e blerjes së librit shkollor në masën 100% disa kategori nxënësish të arsimit parauniversitar ndër ta janë edhe nxënësit që vijnë nga familjet që trajtohen me ndihmë ekonomike sociale nga pushteti vendor. Kështu, nxënësit e kësaj kategorie që kanë përfituar në vitin shkollor 2010-2011 janë 9,452 nxënës, në vlerën totale 20,082,470 lekë, dhe në vitin 2011-2012 janë 9,366 nxënës, në vlerë totale 24,457,399 lekë. Nga krahasimi i të dhënave për vitin shkollor 2009-2010, me vitet 2010-2011 dhe 2011-2012, del se, numri i nxënësve që vijnë nga familje të cilat trajtohen me ndihmë ekonomike sociale në vitin shkollor 2010-2011 është rritur ndjeshëm për 3,876 nxënës, dhe në vitin 2011-2012 për 3,790 nxënës, ose rreth 60% e tyre. Të gjithë këta nxënës përfitues kanë paraqitur në DAR vërtetime nga njësitë vendore përkatëse, ku vërtetojnë se familjet e tyre trajtohen me ndihmë ekonomike. Mendojmë se, kjo rritje e numrit të familjeve të rrethit të Shkodrës që trajtohen me ndihmë ekonomike sociale nuk është reale, por fiktive, pasi vjen nga tendenca me qëllim përfitimi financiar si pasojë e vakumit ligjor, e konkretisht:

Për të përfituar kompensim financiar mjafton që nxënësi të paraqesë vetëm një vërtetim që familja e tij jeton me ndihmë sociale. Por, ky vërtetim mund të merret lehtësisht për rrethana nga më të ndryshme nga njësia vendore ku jeton nxënësi, pasi lëshohet si formular tip dhe mbushet nga nëpunësi i ndihmës ekonomike. Për më tepër, në bazën ligjore nuk kërkohet që vërtetimi të shoqërohet me pagesat mujore apo vjetore të bëra nga njësitë vendore në favor të familjeve që përfitojnë ndihmë ekonomike.

Për eliminimin e këtyre pasojave, **rekomandojmë që:**

- Nxënësve që vijnë nga familjet që trajtohen me ndihmë ekonomike, përveç vërtetimeve përkatëse, të lëshuara nga njësitë vendore, tu kërkohet edhe dokumentacion shtesë që vërteton se janë paguar realisht nga pushteti vendor me ndihmë ekonomike.

Vazhdimisht

6. Të gjithë listat e nxënësve të cilët kanë tërhequr vlerat përfituese të subvencionit nga Posta Shqiptare nuk depozitoheshin në DAR, por mbaheshin nga vetë zyrat postare. Në DAR mbahej vetëm një fotokopje e listave të nxënësve sipas shkollave, të pa nënshkruara nga nxënësit përfitues. Grupit të auditimit, me ndërmjetësinë e DAR-it ju vunë në dispozicion vetëm listat e nxënësve të shkollës së fshatit “Gruda e Re” për të tre vitet shkollore. Nga auditimi i këtyre listave u konstatua se, të gjithë nxënësit përfitues për çdo vit e kishin tërhequr plotësisht vlerën e subvencionit. Listat ishin të plotësuar me numrin e identifikimit dhe nënshkrimin e çdo përfituesi, por disa prej tyre linin për të dëshiruar, pasi të jepnin pamjen sikur ishin plotësuar nga e njëjta dorë.

Me qëllim kryerjen e auditimit të vlerave përfituese të subvencionit të tërhequr për çdo nxënës, **rekomandojmë që:**

- Në përfundim të shpërndarjes së subvencionit, një kopje e listave të nxënësve sipas shkollave, të njësuara me origjinalin, detyrimisht duhen të depozitohet në DAR nga Posta Shqiptare.

Vazhdimisht

7. Të merren masa dhe të ndiqen procedurat ligjore për t’i kërkuar sipërmarrësit [REDACTED] kryerjen e punimeve të pakryera në vlerën totale 274,056 lekë, për Rikonstrukcionin e Palestrës së Shkollës së Mesme “Kol Idromeno”, konkretisht:

- Punimet për mbrojtjen nga shkarkimet atmosferike, në vlerën 196,440 lekë.
- Punimet për përgatitjen e sipërfaqes për mbjellje 84 m², me vlerë 35,280 lekë.
- Punimet për mbjellje me barë e sipërfaqes së parapërgatitur, me vlerë 42,336 lekë.

Menjëherë

C. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI

C.1 Për Drejtorinë Arsimore Rajonale Shkodër

1. Të merren masat e duhura për të kërkuar shpërblimin e dëmit **në vlerën 465,200 lekë**, nga **105 punonjës** arsimtarë që kanë dalë në pension, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit. Kjo vlerë përfaqëson tatimin e pa mbajtur mbi të ardhurat personale në masën 10%, në kundërshtim me aktet ligjore në fuqi (sipas listës bashkëlidhur raportit të auditimit).

Menjëherë

2. Të merren masa për të kërkuar shpërblimin e dëmit **në vlerën 593,514 lekë**, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit, për punonjësit e mëposhtëm:

1. [REDAKTUAR] në vlerën 166,680 lekë;
2. [REDAKTUAR] në vlerën 76,230 lekë;
3. [REDAKTUAR] në vlerën 10,800 lekë;
4. [REDAKTUAR] në vlerën 31,500 lekë;
5. [REDAKTUAR] në vlerën 113,760 lekë;
6. [REDAKTUAR] në vlerën 34,200 lekë;
7. [REDAKTUAR] në vlerën 5,400 lekë;
8. [REDAKTUAR] në vlerën 13,500 lekë;
9. [REDAKTUAR] në vlerën 114,444 lekë;
10. [REDAKTUAR] në vlerën 27,000 lekë;

Këto vlera përfaqësojnë honorarë të përfituar padrejtësisht gjatë zbatimit të projektit “Reduktimi deri në zero i braktisjes së shkollës në arsimin bazë në Shkodër” të financuar nga UNICEF-i në shumën 2,857,460 lekë.

Menjëherë

3. Të merren masa për ti kërkuar shpërblimin e dëmit **në vlerën 28,800 lekë** nga Zëvendësministre e Arsimit dhe Shkencës [REDAKTUAR] dhe në vlerën **28,800 lekë** nga punonjëse e Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës [REDAKTUAR] duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit.

Këto vlera përfaqësojnë honorarë të përfituar padrejtësisht gjatë zbatimit të projektit “Reduktimi deri në zero i braktisjes së shkollës në arsimin bazë në Shkodër” të financuar nga UNICEF-i në shumën 2,857,460 lekë.

Menjëherë

4. Të merren masa për ti kërkuar Anëtarëve të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave: [REDAKTUAR] Anëtarëve të Njesisë së Prokurimit: [REDAKTUAR] si dhe Titullarit të Autoritetit Kontraktor [REDAKTUAR] shpërblimin e dëmit ekonomik **në shumën 1,970,842 lekë**, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit.

Këta punonjës në tenderin për “Rikonstruksionin e Palestrës së Shkollës së Mesme Kol Idromeno”, Shkodër, me fond limit 5,833,333 lekë, në kundërshtim me, kreun VII, pikën 2, dhe kreun IX, germa c të VKM nr.1, datë 10/1/2007 "Për rregullat e prokurimit publik", i ndryshuar, kanë skualifikuar operatorin ekonomik [REDAKTUAR]

i cili ka pasur ofertën ekonomike më të ulët se operatori fitues, e për pasojë buxhetit të shtetit i është shkaktuar dëm ekonomik në këtë vlerë.

Menjëherë

5. Të merren masa për të kërkuar shpërblimin e dëmit **në vlerën 27,034 lekë**, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit, nga subjekti [REDAKTUAR].

Kjo vlerë është përfituar padrejtësisht gjatë zbatimit të kontratës për “Rikonstrukcion i Palestrës së Shkollës së Mesme Kol Idromeno”, me fond limit në vlerën 5,833,333 lekë.

Menjëherë

6. Të merren masa për ti kërkuar Anëtarëve të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave: [REDAKTUAR] dhe Titullarit të Autoritetit Kontraktor [REDAKTUAR] shpërblimin e dëmit ekonomik **në shumën 603,384 lekë**, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit.

Këta punonjës kanë vepruar në kundërshtim me rregullat e prokurimit publik në tenderin “Për blerjen e librave artistik për arsimin 9-vjeçar”, me fond limit 2,885,121 lekë, të realizuar në vitin 2009, pasi dy operatorë ekonomik, të cilët kanë paraqitur ofertat ekonomike me vlera më të ulëta se oferta e fituesit janë tërhequr në mënyrë të njëanshme nga tenderi. Për këtë tërheqje brenda afatit të vlefshmërisë së ofertave, nuk u është konfiskuar sigurimi i ofertave në vlerën 115,404 lekë, në kundërshtim me nenin 49, të ligjit nr. 9643, datë 20/11/2006 “Për Prokurimin Publik” dhe pikën “2”, të kreu III të VKM nr. 1, datë 10/1/2007 “Për rregullat e prokurimit Publik”. Pasoja e kësaj shkelje ka sjellë rritje fiktive të kostos së blerjes së librave në vlerën e mësipërme, që rezulton nga diferenca e vlerës së ofertës fituese me vlerën e ofertës më të ulët të operatorit ”A” shpk, i cili është tërhequr nga tenderi në mënyrë të njëanshme.

Menjëherë

7. Të merren masa për t1 kërkuar Anëtarëve të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave: [REDAKTUAR] dhe Titullarit të Autoritetit Kontraktor [REDAKTUAR] shpërblimin e dëmit ekonomik **në shumën 242,760 lekë**, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit.

Këta punonjës kanë vepruar në kundërshtim me rregullat e prokurimit publik në tenderin “Për blerjen e librave artistik për arsimin e mesëm”, me fond limit 1,071,288 lekë, të realizuar në vitin 2009, pasi dy operatorë ekonomik të cilët kanë paraqitur ofertat ekonomike me vlera më të ulëta se oferta e fituesit janë tërhequr në mënyrë të njëanshme nga tenderi. Për këtë tërheqje brenda afatit të vlefshmërisë së ofertave, nuk u është konfiskuar sigurimi i ofertave në vlerën 42,850 lekë, në kundërshtim me nenin 49, të ligjit nr. 9643, datë 20/11/2006 “Për Prokurimin

Publik” dhe pikën “2”, të kreu III të VKM nr. 1, datë 10/1/2007 “Për rregullat e Prokurimit Publik”. Pasoja e kësaj shkelje ka sjell rritje fiktive të kostos së blerjes së librave në vlerën e mësipërme, që rezulton nga diferenca e vlerës së ofertës fituese me vlerën e ofertës më të ulët të operatorit [REDAKTUAR], i cili është tërhequr nga tenderi në mënyrë të njëanshme.

Menjëherë

8. Të merren masa për t1 kërkuar Anëtarëve të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave: [REDAKTUAR] Anëtarëve të Njësisë së Prokurimit: [REDAKTUAR] dhe Titullarit të Autoritetit Kontraktor [REDAKTUAR] shpërblimin e dëmit ekonomik në shumën **423,918 lekë**, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit.

Këta punonjës kanë vepruar në kundërshtim me rregullat e prokurimit publik në tenderin “Për blerjen e librave artistik për arsimin 9-vjeçar dhe arsimin e mesëm”, me fond limit 2,820,413 lekë, të realizuar në vitin 2010, pasi kanë shmangur procedurën e hapur dhe kanë përdorur procedurën me negociim pa shpallje paraprake të kontratës, në kundërshtim me nenin 33 dhe 53, të ligjit nr. 9643, datë 20/11/2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar dhe me kreun IV të VKM nr. 1, datë 10/1/2007 “Për rregullat e Prokurimit Publik”. Si pasojë e kësaj shkeljeje i është shkaktuar buxhetit të shtetit *dëm ekonomik në vlerën 423,918 lekë*.

Menjëherë

Ç. MASA DISIPLINORE

Ç.1 Mbështetur në nenin 37 të ligjit nr. 7961, datë 12/7/1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, dhe në Kontratën Kolektive të Punës, i rekomandojmë Drejtorisë Arsimore Rajonale, Shkodër, të fillojë procedurën për dhënien e masës disiplinore:

“Vërejtje me shkrim”, për:

1. [REDAKTUAR] me detyrë specialist i Burimeve Njerëzore në DARSH, pasi:

Në zbatimin e dispozitave ligjore dhe në mbajtjen e dokumentacionit që lidhet me marrëdhëniet e punës dhe të pagave janë konstatuar shkelje, mangësi dhe parregullsi të shumta, si:

- Parregullsi të shumta në mbajtjen dhe përpilimin e listë prezencave si, raste me korrigjime, nuk është përcaktuar një format për listë prezencat për të gjitha shkollat, raste që mësuesit në listë prezencë kanë mbiemër tjetër, ndërsa në listë pagesë kanë tjetër mbiemër, raste që në listë prezencë ka të shënuar ditë pune me raport mjekësor dhe në listë pagesë nuk është bërë ndalesa e paftësisë së përkohshme.

- Një pjesë të librezave të punës i kanë drejtorët e shkollave dhe pjesën tjetër të tyre e kanë vetë mësuesit, ndërsa në DAR nuk ka asnjë librezë pune të mësuesve, por janë vetëm dosjet e tyre.
- Në listë prezencat që plotësojnë drejtorët e shkollave nuk shënohet lënda që jep çdo mësues, kualifikimi, si dhe vendbanimi i tyre. Në shumë raste evidentohen ndryshime të numrit të mësuesve, sidomos për mësuesit provizorë, në listë prezencat në disa raste ka numër mësuesish provizorë më pak se në listë pagesa.
- Janë bërë shumë pagesa për orë suplementare si për mësuesit definitivë, ashtu edhe për ata provizorë.
- Nuk kishte kritere të përcaktuara, për zëvendësuesit e mësuesve që ishin me raporte mjekësore për paaftësi të përkohshme, përzgjedhja e tyre bëhej vetëm nga specialisti i Burimeve Njerëzore. Në shumë raste dërgoheshin mësues pa vjetërsi pune dhe pa kualifikim. Shkresat e firmosura nga Drejtore e DAR-it, për emërimin e mësuesve provizor, ishin pa numër protokollit dhe pa shënuar vjetërsinë e punës.
- Përzgjedhja dhe punësimi i drejtuesve të shkollave dhe i mësuesve nga Drejtoria Arsimore bëhej pa konkurs dhe pa zbatuar asnjë kriter të përcaktuar në udhëzimin e Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës nr. 22, datë 29/7/2010 "Për Emërimet e Personelit Mësimor dhe Drejtues në Arsimin Parauniversitar" dhe të Kontratës Kolektive të Punës datë 25/5/2010, të lidhur ndërmjet MASH, Sindikatës së Pavarur të Arsimit të Shqipërisë dhe Federatës së Sindikatave të Arsimit të Shqipërisë.
- Pagesat për orë jashtë orarit nga 8,260 mijë lekë që ishin në vitin 2010 janë dyfishuar në 16,942 mijë lekë në vitin 2011, e cila tregon për një liberalizim dhe fiktivitet në pagimin e orëve jashtë orarit.
- Janë bërë ndalesat e sigurimeve shoqërore e shëndetësore dhe të tatimit mbi të ardhurat personale mbi pagën e ditëve që punonjësit ishin me raport mjekësor për paaftësi të përkohshme në kundërshtim me legjislacionin në fuqi.

Ç.2 Mbështetur në nenin 37 të ligjit nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, dhe në Kontratën Kolektive të Punës, i rekomandojmë, Drejtorit të Drejtorisë Arsimore Rajonale, Shkodër t’i kërkojë Agjencisë së Prokurimit Publik, për të filluar procedurat për dhënien e masës disiplinore:

“Vërejtje me shkrim”, për:

1. [REDAKTUAR] me detyrë Përgjegjëse e Sektorit të Programeve të Zhvillimit në DARSH, pasi ka vepruar:

- Me cilësinë e Anëtarit të Njesisë së Prokurimit, në tenderin për “Rikonstrukcionin e Palestrës së Shkollës së Mesme Kol Idromeno”, Shkodër, me fond limit 5,833,333 lekë, ka vepruar në kundërshtim me, kreun VII, pikën 2, dhe kreun IX,

germa c të VKM nr.1, datë 10/1/2007 "Për rregullat e Prokurimit Publik", i ndryshuar, duke skualifikuar operatorin ekonomik [REDAKTUAR] i cili ka pasur ofertën ekonomike më të ulët se operatori fitues, **duke shkaktuar dëm ekonomik për buxhetin e shtetit në vlerën 1,970,842 lekë.**

- *Me cilësinë e Anëtarit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave*, në tenderin "Për blerjen e librave artistik për arsimin 9-vjeçar dhe arsimin e mesëm", me fond limit 2,820,413 lekë, të realizuar në vitin 2010, ka përdorur procedurën me negociim pa shpallje paraprake të kontratës, në kundërshtim me nenin 33, të ligjit nr. 9643, datë 20/11/2006 "Për Prokurimin Publik", i ndryshuar dhe me kreun IV të VKM nr. 1, datë 10/1/2007 "Për rregullat e Prokurimit Publik". **Si pasojë e kësaj shkeljeje i është shkaktuar buxhetit të shtetit dëm ekonomik në vlerën 423,918 lekë.**

2. [REDAKTUAR] me detyrë Jurist në DARSH, pasi ka vepruar:

- *Me cilësinë e Anëtarit të Njesisë së Prokurimit*, në tenderin për "Rikonstruksionin e Palestrës së Shkollës së Mesme Kol Idromeno", Shkodër me fond limit 5,833,333 lekë, ka vepruar në kundërshtim me, kreun VII, pikën 2, dhe kreun IX, germa c të VKM nr.1, datë 10/1/2007 "Për rregullat e Prokurimit Publik", i ndryshuar, duke skualifikuar operatorin ekonomik [REDAKTUAR] i cili ka pasur ofertën ekonomike më të ulët se operatori fitues, **duke shkaktuar dëm ekonomik për buxhetin e shtetit në vlerën 1,970,842 lekë.**

3. [REDAKTUAR] me detyrë Specialist në DARSH, pasi ka vepruar:

- *Me cilësinë e Anëtarit të Njesisë së Prokurimit*, në tenderin për "Rikonstruksionin e Palestrës së Shkollës së Mesme Kol Idromeno", Shkodër me fond limit 5,833,333 lekë, ka vepruar në kundërshtim me, kreun VII, pikën 2, dhe kreun IX, germa c të VKM nr.1, datë 10/1/2007 "Për rregullat e prokurimit publik", i ndryshuar, duke skualifikuar operatorin ekonomik [REDAKTUAR] i cili ka pasur ofertën ekonomike më të ulët se operatori fitues, **duke shkaktuar dëm ekonomik për buxhetin e shtetit në vlerën 1,970,842 lekë.**

- *Me cilësinë e Anëtarit të Njesisë së Prokurimit*, në tenderin "për blerjen e librave artistik për arsimin 9-vjeçar dhe arsimin të mesëm", me fond limit 2,820,413 lekë", të realizuar në vitin 2010 ka përdorur procedurës me negociim pa shpallje paraprake të kontratës në kundërshtim me: nenin 33, të ligjit nr. 9643, datë 20/11/2006 "Për Prokurimin Publik", i ndryshuar dhe me kreun IV të VKM nr. 1, datë 10/1/2006 "Për rregullat e Prokurimit Publik". Si pasojë e kësaj shkeljeje, **është shkaktuar dëm ekonomik në vlerën 423,918 lekë.**

4. [REDAKTUAR] me detyrë ish Përgjegjës Sektorit të Shërbimeve të Përgjithshme në DARSH, pasi ka vepruar:

- *Me cilësinë e Anëtarit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave*, në tenderin për "Rikonstruksionin e Palestrës së Shkollës së Mesme Kol Idromeno", Shkodër me

fond limit 5,833,333 lekë, ka vepruar në kundërshtim me kreun VII, pikën 2, dhe kreun IX, germa c të VKM nr. 1, datë 10/1/2007 "Për rregullat e Prokurimit Publik", i ndryshuar, duke skualifikuar operatorin ekonomik [REDACTED] i cili ka pasur ofertën ekonomike më të ulët se operatori fitues, **duke shkaktuar dëm ekonomik për buxhetin e shtetit në vlerën 1,970,842 lekë.**

- Në tenderin "Për blerjen e librave artistik për arsimin 9-vjeçar", me fond limit 2,885,121 lekë, të realizuar në vitin 2009, ka vepruar në kundërshtim me rregullat e prokurimit publik, pasi dy operatorë ekonomik të cilët kanë paraqitur ofertat ekonomike me vlera më të ulëta se oferta e fituesit janë tërhequr në mënyrë të njëanshme nga tenderi. Për këtë tërheqje brenda afatit të vlefshmërisë së ofertave, nuk u është konfiskuar sigurimi i ofertave në vlerën **115,404 lekë**, në kundërshtim me nenin 49, të ligjit nr. 9643, datë 20/11/2006 "Për Prokurimin Publik" dhe pikën "2", të kreu III të VKM nr. 1, datë 10/1/2007 "Për rregullat e prokurimit Publik". Pasoja e kësaj shkeljeve ka sjell rritje fiktive të kostos së blerjes së librave, **duke shkaktuar dëm ekonomik për buxhetin e shtetit në vlerën 603,384 lekë.**

- Në tenderin "Për blerjen e librave artistik për arsimin e mesëm", me fond limit 1,071,288 lekë, të realizuar në vitin 2009, ka vepruar në kundërshtim me rregullat e prokurimit publik, pasi dy operatorë ekonomik të cilët kanë paraqitur ofertat ekonomike me vlera më të ulëta se oferta e fituesit janë tërhequr në mënyrë të njëanshme nga tenderi. Për këtë tërheqje brenda afatit të vlefshmërisë së ofertave, nuk u është konfiskuar sigurimi i ofertave në vlerën 42,850 lekë, në kundërshtim me nenin 49 të ligjit nr. 9643, datë 20/11/2006 "Për Prokurimin Publik" dhe pikën "2", të kreu III të VKM nr. 1, datë 10/1/2007 "Për rregullat e Prokurimit Publik". Pasoja e kësaj shkeljeve ka sjellë rritje fiktive të kostos së blerjes së librave, **duke shkaktuar dëm ekonomik për buxhetin e shtetit në vlerën 242,760 lekë.**

5. [REDACTED] Specialist i Jashtëm, pasi ka vepruar:

- *Me cilësinë e Anëtarit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave*, në tenderin për "Rikonstruksionin e Palestrës së Shkollës së Mesme Kol Idromeno", Shkodër me fond limit 5,833,333 lekë, ka vepruar në kundërshtim me kreun VII, pikën 2, dhe kreun IX, germa c të VKM nr.1, datë 10/1/2007 "Për rregullat e Prokurimit Publik", i ndryshuar, duke skualifikuar operatorin ekonomik [REDACTED] i cili ka pasur ofertën ekonomike më të ulët se operatori fitues, **duke shkaktuar dëm ekonomik për buxhetin e shtetit në vlerën 1,970,842 lekë.**

6. [REDACTED] me detyrë Specialiste në DARSH, pasi ka vepruar:

- *Me cilësinë e Anëtarit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave*, në tenderin për "Rikonstruksionin e Palestrës së Shkollës së Mesme Kol Idromeno", Shkodër me fond limit 5,833,333 lekë, ka vepruar në kundërshtim me kreun VII, pikën 2, dhe kreun IX, germa c të VKM nr. 1, datë 10/1/2007 "Për rregullat e Prokurimit Publik", i ndryshuar, duke skualifikuar operatorin ekonomik [REDACTED] i cili ka

pasur ofertën ekonomike më të ulët se operatori fitues, **duke shkaktuar dëm ekonomik për buxhetin e shtetit në vlerën 1,970,842 lekë.**

- *Me cilësinë e Anëtares së Njësisë së Prokurimit*, në tenderin “Për blerjen e librave artistik për arsimin 9-vjeçar”, me fond limit 2,885,121 lekë, të realizuar në vitin 2009, ka vepruar në kundërshtim me rregullat e prokurimit publik, pasi dy operatorë ekonomik të cilët kanë paraqitur ofertat ekonomike me vlera më të ulëta se oferta e fituesit janë tërhequr në mënyrë të njëanshme nga tenderi. Për këtë tërheqje brenda afatit të vlefshmërisë së ofertave, nuk u është konfiskuar sigurimi i ofertave në vlerën 115,404 lekë, në kundërshtim me nenin 49 të ligjit nr. 9643, datë 20/11/2006 “Për Prokurimin Publik” dhe pikën “2”, të kreu III të VKM nr. 1, datë 10/1/2007 “Për rregullat e Prokurimit Publik”. Pasoja e kësaj shkelje ka sjellë rritje fiktive të kostos së blerjes së librave, **duke shkaktuar dëm ekonomik për buxhetin e shtetit në vlerën 603,384 lekë.**

- *Me cilësinë e Anëtares së Njësisë së Prokurimit*, në tenderin “Për blerjen e librave artistik për arsimin e mesëm”, me fond limit 1.071.288 lekë, të realizuar në vitin 2009, ka vepruar në kundërshtim me rregullat e prokurimit publik, pasi dy operatorë ekonomik të cilët kanë paraqitur ofertat ekonomike me vlera më të ulëta se oferta e fituesit janë tërhequr në mënyrë të njëanshme nga tenderi. Për këtë tërheqje brenda afatit të vlefshmërisë së ofertave, nuk u është konfiskuar sigurimi i ofertave në vlerën 42,850 lekë, në kundërshtim me nenin 49, të ligjit nr. 9643, datë 20/11/2006 “Për Prokurimin Publik” dhe pikën “2”, të kreu III të VKM nr. 1, datë 10/1/2007 “Për rregullat e Prokurimit Publik”. Pasoja e kësaj shkelje ka sjellë rritje fiktive të kostos së blerjes së librave, **duke shkaktuar dëm ekonomik për buxhetin e shtetit në vlerën 242,760 lekë.**

- *Me cilësinë e Anëtares së Njësisë së Prokurimit*, në tenderin “Për blerjen e librave artistik për arsimin 9-vjeçar dhe arsimin e mesëm”, me fond limit 2,820,413 lekë, të realizuar në vitin 2010 kanë përdorur procedurës me negociim pa shpallje paraprake të kontratës në kundërshtim me: nenin 33, të ligjit nr. 9643, datë 20/11/2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar dhe me kreun IV të VKM nr. 1, datë 10/1/2007 “Për rregullat e Prokurimit Publik”. **Si pasoje e kësaj shkelje është shkaktuar dëm ekonomik në vlerën 423,918 lekë.**

7. **██████████ me detyrë Specialiste në DARSH**, pasi ka vepruar:

- *Me cilësinë e Anëtarit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave*, në tenderin “Për blerjen e librave artistik për arsimin 9-vjeçar”, me fond limit 2,885,121 lekë, të realizuar në vitin 2009, ka vepruar në kundërshtim me rregullat e prokurimit publik, pasi dy operatorë ekonomik të cilët kanë paraqitur ofertat ekonomike me vlera më të ulëta se oferta e fituesit janë tërhequr në mënyrë të njëanshme nga tenderi. Për këtë tërheqje brenda afatit të vlefshmërisë së ofertave, nuk u është konfiskuar sigurimi i ofertave në vlerën 115,404 lekë, në kundërshtim me nenin 49

të ligjit nr. 9643, datë 20/11/2006 “Për Prokurimin Publik” dhe pikën “2”, të kreu III të VKM nr. 1, datë 10.01.2007 “Për rregullat e Prokurimit Publik”. Pasoja e kësaj shkelje ka sjellë rritje fiktive të kostos së blerjes së librave, **duke shkaktuar dëm ekonomik për buxhetin e shtetit në vlerën 603,384 lekë.**

- *Me cilësinë e Anëtarit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave*, në tenderin “Për blerjen e librave artistik për arsimin e mesëm”, me fond limit 1,071,288 lekë, të realizuar në vitin 2009, ka vepruar në kundërshtim me rregullat e prokurimit publik, pasi dy operatorë ekonomik të cilët kanë paraqitur ofertat ekonomike me vlera më të ulëta se oferta e fituesit janë tërhequr në mënyrë të njëanshme nga tenderi. Për këtë tërheqje brenda afatit të vlefshmërisë së ofertave, nuk u është konfiskuar sigurimi i ofertave në vlerën 42,850 lekë, në kundërshtim me nenin 49, të ligjit nr. 9643, datë 20/11/2006 “Për Prokurimin Publik” dhe pikën “2”, të kreu III të VKM nr. 1, datë 10/1/2007 “Për rregullat e Prokurimit Publik”. Pasoja e kësaj shkelje ka sjellë rritje fiktive të kostos së blerjes së librave, **duke shkaktuar dëm ekonomik buxhetit të shtetit në vlerën 242,760 lekë.**

- *Me cilësinë e Anëtarit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave*, në tenderin “për blerjen e librave artistik për arsimin 9-vjeçar dhe arsimin të mesëm”, me fond limit 2,820,413 lekë”, të realizuar në vitin 2010 ka përdorur procedurës me negociim pa shpallje paraprake të kontratës në kundërshtim me: nenin 33, të ligjit nr. 9643, datë 20/11/2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar dhe me kreun IV të VKM nr. 1, datë 10/1/2006 “Për rregullat e Prokurimit Publik”. **Si pasoje e kësaj shkeljeje është shkaktuar dëm ekonomik në vlerën 423,918 lekë.**

8. Për, [REDAKTUAR] me detyrë Juriste në DARSH, pasi ka vepruar:

- *Me cilësinë e Anëtares së Njësisë së Prokurimi*, në tenderin “për blerjen e librave artistik për arsimin 9-vjeçar dhe arsimin të mesëm”, me fond limit 2,820,413 lekë”, të realizuar në vitin 2010 ka përdorur procedurës me negociim pa shpallje paraprake të kontratës në kundërshtim me: nenin 33, të ligjit nr. 9643, datë 20/11/2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar dhe me kreun IV të VKM nr. 1, datë 10/01/2006 “Për rregullat e Prokurimit Publik”. Si pasoje e kësaj shkeljeje, **është shkaktuar dëm ekonomik në vlerën 423,918 lekë.**

9. Për [REDAKTUAR] me detyrë Specialist në DARSH, pasi ka vepruar:

- *Me cilësinë e Anëtarit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave*, në tenderin “për blerjen e librave artistik për arsimin 9-vjeçar dhe arsimin të mesëm”, me fond limit 2,820,413 lekë”, të realizuar në vitin 2010 ka përdorur procedurës me negociim pa shpallje paraprake të kontratës në kundërshtim me: nenin 33, të ligjit nr. 9643, datë 20/11/2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar dhe me kreun IV të VKM nr. 1, datë 10/1/2006 “Për rregullat e Prokurimit Publik”. Si pasoje e kësaj shkeljeje, **është shkaktuar dëm ekonomik në vlerën 423,918 lekë.**

E. KALLËZIM PENAL

Bazuar në kualifikimet e neneve 248 “Shpërdorimi i detyrës” dhe 258 “Shkelja e barazisë së pjesëmarrësve në tenderë apo ankande publikë”, të Kodit Penal, të bëjmë kallëzim penal për [REDAKTUAR] me detyrë Drejtore e Drejtorisë Arsimore Rajonale Shkodër, pasi:

1. Në bazë të marrëveshjes së bashkëpunimit, UNICEF-i ka financuar DAR-in në shumën 2,857,460 lekë për zbatimin e projektit “Reduktimi deri në zero i braktisjes së shkollës në arsimin bazë në Shkodër”. Rezultatet e pritshme që do të vijnë nga realizimi i këtij projekti do të ishin, rreth 100 fëmijë si kontigjent i braktisjes do të ktheheshin në shkollë, si dhe prindërit e tyre do të përfshihen në proceset e vendimmarrjes si, pjesë aktive e bordeve të shkollave. Projekti, nuk ka arritur qëllimin dhe rezultatet e pritshme, pasi dokumentacioni i zbatimit të projektit në pjesën më të madhe të tij, sidomos listat e identifikimit të nxënësve kontigjent të braktisjes janë hartuar ose janë marrë të gatshme nga drejtoritë e shkollave. Nuk vërtetohet se, nxënësit janë identifikuar dhe listat janë përgatitur nga puna e stafit të projektit. Në këtë kontekst, mjafton të përmëndim faktin se *vetëm 10 punonjës të DAR dhe 2 punonjës të MASH kanë përfituar honorare nga ky projekt rreth 651.114 lekë dhe vetëm [REDAKTUAR] ka përfituar 166,680 lekë (pa tatimin), në një kohë që, punën për zbatimin e projektit e kanë kryer njëkohësisht me ushtrimin e detyrave funksionale në DAR, për të cilën kanë marrë edhe pagën. Kanë përfituar honorare si, pjesë e stafit edhe Z/V Ministre e MASH-it në vlerën 28,800 lekë. Po kështu edhe disa punonjës të DAR-it, si pjesë e stafit të projektit janë trajtuar në kampet verore të këtyre fëmijëve të financuar nga ky projekt. Pra, të gjitha këto tregojnë për një punë të pamatshme të stafit të projektit, pasi për zbatimin e tij nuk kanë punuar punonjësit e stafit, por është shfrytëzuar puna dhe detyra funksionale e punonjësve të DAR-it, si dhe dokumentet dhe statistikat e gatshme të shkollave.*

2. *Me cilësinë e Titullares së Autoritetit Kontraktor, ka vepruar në kundërshtim me nenin 12 të ligjit për prokurimin publik dhe me rregjistrin e parashikimit të prokurimeve të miratuar nga MASH-i, pasi gjatë periudhës objekt auditimi, ka pasur fonde në dispozicion për prokurimin e mallrave, shërbimeve dhe punëve në vlerën **totale 164,261,479 lekë**, dhe nga veprimet apo mosveprimet e tij ka arritur të prokurojë vetëm 22,156,409 lekë, ose ka prokuruar dhe realizuar rreth 14% të fondeve në dispozicion. Pra, nga 142,105,000 lekë fonde buxhetore të vëna në dispozicion nga buxheti për mbarëvajtjen normale të aktivitetit mësimor të kësaj Drejtorie nuk ka qenë në gjëndje ti prokurojë dhe realizojë.*

3. *Me cilësinë e Titullares së Autoritetit Kontraktor, në tenderin “për “Rikonstruksionin e Palestrës së Shkollës së Mesme Kol Idromeno”, Shkodër me*

fond limit 5,833,333 lekë, në kundërshtim me, kreun VII, pikën 2, dhe kreun IX, gërma c të VKM nr.1, date 10/1/2007 "Për rregullat e prokurimit publik", i ndryshuar, ka ndikuar në skualifikimin e operatorit ekonomik [REDAKTUAR] i cili ka pasur ofertën ekonomike me të ulët se operatori fitues, dhe **për pasojë i është shkaktuar buxheti të shtetit dem ekonomik në vlerën 1,970,842 lekë.**

4. Me cilësinë e Titullares së Autoritetit Kontraktor ka vepruar në kundërshtim me rregullat e prokurimit publik në tenderin "për blerjen e librave artistik për arsimin 9-vjeçar", me fond limit 2,885,121 lekë", të realizuar në vitin 2009, pasi dy operatorë ekonomik të cilët kanë paraqitur ofertat ekonomike me vlera më të ulëta se oferta e fituesit janë tërhequr në mënyrë të njëanshme nga tenderi. Për këtë tërheqje brenda afatit të vlefshmërisë së ofertave, nuk u është konfiskuar sigurimi i ofertave në vlerën 115,404 lekë në kundërshtim me nenin 49, të ligjit nr. 9643, datë 20/11/2006 "Për Prokurimin Publik" dhe pikën "2", të kreu III të VKM nr. 1, datë 10/1/2007 "Për rregullat e prokurimit Publik". Pasoja e kësaj shkeljeve ka sjell rritje fiktive të kostos së blerjes së librave duke i shkaktuar buxheti të shtetit dem ekonomik në vlerën **603,384 lekë** që ka rezultuar nga diferenca e vlerës së ofertës fituese me vlerën e ofertës më të ulët të operatorit [REDAKTUAR] i cili është tërhequr nga tenderi në mënyrë të njëanshme.

5. Me cilësinë e Titullares së Autoritetit Kontraktor ka vepruar në kundërshtim me rregullat e prokurimit publik në tenderin "për blerjen e librave artistik për arsimin e mesëm", me fond limit 1.071.288 lekë", të realizuar në vitin 2009, pasi dy operatorë ekonomik të cilët kanë paraqitur ofertat ekonomike me vlera më të ulëta se oferta e fituesit janë tërhequr në mënyrë të njëanshme nga tenderi. Për këtë tërheqje brenda afatit të vlefshmërisë së ofertave, nuk u është konfiskuar sigurimi i ofertave në vlerën 42,850 leke në kundërshtim me nenin 49, të ligjit nr. 9643, datë 20/11/2006 "Për Prokurimin Publik" dhe pikën "2", të kreu III të VKM nr. 1, datë 10/1/2007 "Për rregullat e prokurimit Publik". Pasoja e kësaj shkeljeve ka sjell rritje fiktive të kostos së blerjes së librave duke shkaktuar dem ekonomik për buxhetin e shtetit në vlerën **242,760 lekë** që ka rezultuar nga diferenca e vlerës së ofertës fituese me vlerën e ofertës më të ulët të operatorit [REDAKTUAR] i cili është tërhequr nga tenderi në mënyrë të njëanshme.

6. Me cilësinë e Titullares së Autoritetit Kontraktor, në tenderin "për blerjen e librave artistik për arsimin 9-vjeçar dhe arsimin të mesëm", me fond limit 2,820,413 lekë", të realizuar në vitin 2010 ka shmangur procedurën e hapur dhe ka përdorur procedurën me negociim pa shpallje paraprake të kontratës në kundërshtim me: nenin 33, të ligjit nr. 9643, datë 20/11/2006 "Për Prokurimin Publik", i ndryshuar dhe me kreun IV të VKM nr.1, datë 10/1/2006 "Për rregullat

e Prokurimit Publik”. Si pasoje e kësaj shkeljeje *i është shkaktuar buxhetit të shtetit dëm ekonomik në vlerën 423,918 lekë.*

7. *Me cilësinë e Titullares së Autoritetit Kontraktor*, në zbatimin e procedurave të prokurimit për blerjen e librave artistik për Arsimin Bazë dhe të Mesëm, me fond limit 3,952,419 lekë, si pasojë e shmangies së procedurës së hapur apo të kufizuar dhe përdorimit të procedurës me negociim, Autoriteti Kontraktor nuk ka përmbushur qëllimin e përcaktuar në nenin 1 të ligjit për prokurimin publik, pasi nuk ka rritur efikasitetin dhe efikasitetin e procedurave të prokurimit, nuk ka nxitur konkurrencën dhe pjesëmarrjen në procedurat e prokurimit, si dhe nuk ka siguruar mirëpërdorim të fondeve, duke mos ulur koston e blerjes së librave artistik.

8. Gjatë periudhës objekt auditimi, DAR-it i janë vënë në dispozicion fonde buxhetore, për shpenzimet e transportit të mësuesve dhe nxënësve, në vlerën totale prej 134,000,000 lekë. Për pamundësi të realizimit të procedurave të prokurimit për shkak të mos interesit të operatorëve ekonomik, këto shpenzime nuk janë kryer nëpërmjet procedurave të prokurimit, por janë paguar direkt në llogaritë bankare të mësuesve e nxënësve. Pagesat për këtë shërbim janë bërë në zbatim të Udhëzimit të Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës nr. 22, datë 29/5/2008, i cili lejon kryerjen e këtij shërbimi pa procedura prokurimi. Por, ky udhëzim ka dalë dhe bie në kundërshtim me ligjin për prokurimin publik, i cili nuk e përjashton procedurën e prokurimit për këtë shërbim. Po kështu, ky udhëzim bie në kundërshtim edhe me VKM nr.486, datë 8/4/2008 “Për përdorimin e fondeve buxhetore për transportin e mësuesve dhe të nxënësve, që punojnë e mësojnë jashtë vendbanimit” pasi, kjo VKM përcakton qartazi se, shpenzimet dhe fondi limit për këto shërbime prokurohen në mbështetje të ligjit të prokurimin publik. Për pasojë, Autoriteti Kontraktor nuk ka përmbushur objektin dhe qëllimin kryesor të përcaktuar në nenin 1 të ligjit për prokurimin publik, pasi nuk është siguruar mirëpërdorimi i këtyre fondeve dhe ulja e koston së këtij shërbimi. Autoriteti Kontraktor nuk duhet të shfrytëzonte këtë vakum ligjor apo përmbajtjen e këtij udhëzimi, por në bashkëpunim me MASH-in, duhet të rishikonte vlerat apo tarifat e këtij shërbimi, si dhe kriteret, kërkesat apo procedurat që lidhen me kualifikimin e operatorëve ekonomik, me qëllim nxitjen e pjesëmarrjes në prokurim, për uljen e shpenzimeve të këtij shërbimi nëpërmjet procedurave të prokurimit.

9. DAR Shkoder, ka përfituar subvencion nga MASH për të kompensuar nxenesit per cmimet e blerjes së librit shkollor, konkretisht: per vitin shkollor 2008-2009, ne vleren 25,342,090 leke, per vitin 2009-2010, ne vleren 31,545,820 leke, per vitin 2010-2011, ne vleren 20,082,470 leke dhe per vitin 2011-2012, ne vleren 24,457,399 leke. Nuk u krye auditimi i vlerave përfituese të subvencionit të tërhequr për çdo nxënës, *pasi të gjithë listat e nxënësve të cilët kanë tërhequr*

financimin nga Posta Shqiptare nuk riktheheshin për tu depozituar në DARSH, por mbaheshin nga vetë zyrat postare. Në DAR mbahej vetëm një fotokopje e listave të nxënësve sipas shkollave, të pa nënshkuara nga përfituesit. Vlen të përmendim vetëm faktin se, grupit të auditimit, me ndërmjetësinë e DAR-it ju vunë në dispozicion vetëm listat e nxënësve të shkollës së fshatit “Gruda e Re” për të tre vitet shkollore. Nga auditimi i këtyre listave u konstatua se, të gjithë nxënësit përfitues për çdo vit i kishin tërhequr financimet 100%. Listat ishin të plotësuar me numrin e identifikimit dhe nënshkrimin e çdo përfituesi, por disa prej tyre linin për të dëshiruar, pasi të jepnin pamjen sikur ishin plotësuar nga e njëjta dorë. Për mosmbajtja e listave të nxënësve përfitues në DAR të cilat shërbejnë si dokumenta financiar justifikues për vlerat e përfituara dhe të tërhequra nga cdo nxënës lejon hapësira për abuzime.

10. Për vitin 2011, nuk është bashkëpunuar me Ministrinë e arsimit dhe Shkencës për hartimin e strategjisë së politikave, e cila përmban objektivat strategjike, prioritetet e institucionit dhe planet e veprimit.

11. DARSH ka hartuar dhe miratuar rregulloren e brendshme, por kjo rregullore nuk është dërguar për tu miratuar nga Ministri Arsimit dhe Shkencës. Në rregullore nuk janë pasqyruar kërkesat e ligjit për menaxhimin financiar dhe kontrollin, për të përcaktuar detyrat e Nëpunësit Autorizues, Nëpunësit Zbatues, të secilit sektor dhe të punonjësve në veçanti.

12. Për vitin 2011, nuk janë ndërmarrë hapat e përcaktuara në nenin 21 të ligjit për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, pasi nuk është hartuar dhe miratuar strategjia e riskut apo përcaktimi i procedurave për menaxhimin e riskut.

Shënim: Auditimi u krye nga audituesit Bashkim Arizaj Përgjegjës Grupi, Dritan Kore, Selime Bicaj dhe Vladimir Vangjeli. Më tej u shqyrtua nga Kryeaudituesi i Departamentit zj. Luljeta Nano, Drejtori i Departamentit z. Ded Trieshi dhe Juristi i Drejtorisë Juridike dhe Kontrollit të Cilësisë z. Koço Sokoli (në mungesë të Drejtorit të Drejtorisë dhe me porosi), si dhe u verifikua si praktikë nga Drejtori i Përgjithshëm z. Robert Gjini.

KONTROLLI I LARTË I SHTETIT